



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports
DEPARTAMENTI I RINISË/ DEPARTMAN MLADIH/ DEPARTMENT OF YOUTH

Prishtinë, 29.08.2019

THIRRJE PËR APLIKIM PËR GRANTE PËR START-UP

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit bazuar në Planin e Veprimit për Punësimin e të Rinjve 2018-2020 fton të rinjtë e moshës 18-24 vjeç që kanë përfunduar trajnimet për ndërmarrësi gjatë vitit 2019 nga MKRS të aplikojnë për grante për start-up.

Objektivi kryesor i Programit është që të sigurojë mundësi për të rinjtë e papunë për ta nisur një veprimtari biznesi.

Veprimtaritë prioritare që do të mbështetet nga ky program:

Përparësi (por nuk kufizohen) do të kenë këto sektor të biznesit:

- Sektorët prodhues dhe të shërbimit;
- Sektorët e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK);
- Sektorin e industrisë së lehtë;
- Industria e tekstilit;
- Sektorin e Turizmi;
- Fushën e kërkimit dhe të zhvillimit;
- Fushën e dizenjimit, modelimit, artizanatit.
- Zanatet dhe shërbimet specifike si : Floktare, Auto-Mekanik, Auto-Ngjyrosje, Gomister etj

Grantet do të përdoren për të mbështetur krijimin e ndërmarrjeve të reja inovative dhe promovimin e punësimit të të rinjve, të cilët dëshmojnë që mjetet e ndara do të ndikojnë në:

- Zvogëlimin e papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë;
- Aktivitetet prodhuese dhe shërbyese;
- Hapjen e vendeve të reja të punës;
- Investimin në hulumtim dhe zhvillim;
- Rritjen e konkurrueshmërisë dhe kapaciteteve;
- Përmirësimin e proceseve dhe zhvillimin e produkteve të reja;
- Ngritjen e nivelit të pjesëmarrjes së të rinjve në të bërit biznes;

Idetë e biznesit që nuk janë të pranueshme për aplikim janë:

- të gjitha llojet e veprimtarive në kuadër të sektorit primar të bujqësisë;
- tregtia (me pakicë e shumicë), ndërtimtaria, dhe shëndetësi
- veprimtaritë me patundshmëri, lizing;
- veprimtaritë financiare dhe të sigurimeve dhe veprimtaritë që përfshijnë bixhozin;
- prodhimi i pijeve me përmbajtje të lartë të alkoolit;
- prodhimi i produkteve të duhanit;
- prodhimi duke përdorur teknologji që çojnë në ndotje të mjedisit (si ndotje të ajrit, tokës etj.);
- bizneset joformale nuk do pranohen për aplikim;
- bizneset që përshihen të kenë lokacionin në mjedise familjare.

Kostot e kualifikueshme janë:

Kosoto e pranueshme që mund të mbulohen nga paratë e grantit duhet të shfrytëzohen për zbatimin e planit të biznesit dhe mund të përfshijnë:

- Mbështetja e zyrës (qiraja e objektit dhe shpenzimet për zyre);
- Kostot për blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve;
- Kostot për krijimi e aplikacioneve softverike
- Kostot që kanë të bëjnë me stokun fillestar për implementimin e aktiviteteve dhe që janë të domosdoshme për implementimin e projektit;

Kufizimet për kosoto e pranueshme:

- deri në 30% të grantit mund të shfrytëzohet për mbështetjen e zyrës (qiraja e objektit dhe shpenzimet për zyre);
- blerja e lëndës së parë mund të mbulohet vetëm një herë, si blerje e njëhershme e stokut fillestar;
- deri në 50% mund të shfrytëzohet për blerjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve;
- deri në 20% të grantit mund të shfrytëzohet për krijimi e aplikacioneve softverike

Kostot e papranueshme që nuk mund të mbulohen nga granti përfshijnë:

- kostot e publikimi dhe kostot e zhvendosjes;
- shpenzimet e pagave
- blerja e tokës apo ndërtesave, duke përfshirë çdo rinovim etj.;
- blerjen e mjeteve transportuese;
- shpenzimet e transportit të produkteve;
- tatimet në të hyra;
- tarifatat bankare, shpenzimet e garancive dhe tarifa të ngjashme;
- shpenzimet tjera operationale (internet, rryma, uji etj.)
- marrja me qira e hapësirës për zyre nga qiradhënësi që merr pjesë në aktivitetet e projektit ose është i lidhur me kapitalin e përfituesit/ve;
- çdo shpenzim që nuk është i lidhur me biznesin e propozuar;
- shpenzimet e bëra para lidhjes së kontratës për grantin;
- shpenzime të paplanifikuara.

Shuma e grantit

Skema e Ndërmarrësisë do të sigurojë ndihmë me grante në vlerë deri **5,000 Euro** për çdo plan biznesi të zhvilluar me sukses që është miratuar në kuadër të procesit të përzgjedhjes. Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga MKRS nuk mund të tejkalohet 6 muaj. Buxheti total i përafërt i paraparë për skemën e granteve është **450,000 Euro** dhe përmes tij planifikohet të përkrahen deri **100 grante** për start-up. MKRS rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Aplikimet me pikët më të larta do të zgjedhën deri në arrijen e buxhetit në dispozicion.

Të drejtë aplikimi kanë vetëm të rinjtë e moshës 18- 24 të cilët janë certifikuar nga programi i Fondit Rinore i MKRS në vitin 2019 dhe të cilët:

- Janë të papunë;
- Nuk kanë përfituar më herët grante nga MKRS ose burime tjera publike;
- Nuk kanë të hapur biznes përpara thirrjes për aplikim për grante.

Dokumentacioni i kërkuar

Aplikuesi duhet të plotësojnë edhe kriteret e veçanta minimale të parapara me dispozitat në vijim:

- Formulari i Planit të Biznesit;
- CV e aplikuesit;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e certifikatë së trajnimit për ndërmarrësi;
- Vërtetimin nga Gjykata që aplikuesi nuk është nën hetime.

Si të aplikoni?

Plani i Biznesit duhet të dorëzohet vetëm në formularin e paraparë (i plotësuar me kompjuter), i cili është në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (www.mkrs-ks.org).

Aplikacionet duhet të dorëzohen personalisht në **një origjinal dhe një kopje identike në CD**, në një zarf të mbyllur te Zyra e Arkivës në MKRS.

Adresa: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi Nëna Terezë; Zyra e Arkivës, Nr. 22; 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Mbi zarf duhet të shkruhet si me poshtë:

- Programi i granteve për ndërmarrësi
- Emri dhe mbiemri i aplikuesit

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është deri më **23 Shtator 2019, ora 15:00**.

Lista e fitueseve do të publikohet në faqe të internetit të MKRS. Vetëm aplikuesit nga lista fituese janë obliguar të regjistrojnë biznesin e tyre në mënyrë në mënyrë që të mund të përfitojnë nga skema e granteve për start-up.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike për grante start-up mund të sqarohen në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: burim.mexhuani@rks-gov.net

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet në përputhje me objektivat e Programit (fondit) për Rritjen e punësimit përmes për financimin e Start-up. Mënyra e vlerësimit është përshkruar në tabelën e mëposhtme:

Kriteret e vlerësimit të Planit të Biznesit	Pikët totale
Përputhja me objektivat e Programit (Fondit Rinor) për rritjen e punësimit përmes financimit të start-up	1-30 Pikë
Mundësia e realizimit të suksesit në arritjen e rezultateve të synuara.	1-40 Pikë
Krijimi i vendeve të reja të punës (me përparësi gratë dhe të rinjtë)	1-20 Pikë
Vlera e shtuar e biznesit	1-10 Pikë
Pikët totale të mundshme	100 pikë